



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 99

Tiranë – E mërkurë, 23 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshilli të Ministrave nr. 25, datë 22.6.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 9703
Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 365, datë 22.6.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 43, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik” 9703
Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 369, datë 22.6.2021	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, ratifikuar me ligjin nr. 170/2014..... 9704
Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 370, datë 22.6.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tregut të gjësë së gjallë”, Bashkia Korçë..... 9706
Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 371, datë 22.6.2021	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor tek Autoriteti Rrugor Shqiptar, të pasurisë me nr. 6/30, zona kadastrale 8562, Korçë. 9708
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 255, datë 17.6.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 216, datë 29.5.2020, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi GFCM/43/2019/5]”..... 9710
	Korrigjim gabimi në vendimin nr. 3, datë 8.2.2021, të Këshillit të Lartë të Arkivave, “Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve, për ruajtje të përhershme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 26 , datë 18.2.2021..... 9710

**AKT NORMATIV**
Nr. 25, datë 22.6.2021**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9936, DATË 26.6.2008,
“PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT
BUXHETOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në pikën 5, të nenit 4/1, fjalët “... vitit buxhetor 2023 ...” zëvendësohen me “... vitit buxhetor 2024 ...”.

Neni 2

Në fund të nenit 74, “Dispozita kalimtare”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, për vitin 2021, nuk zbatohen parimet dhe rregullat fiskale të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 4/1, të këtij ligji.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 365, datë 22.6.2021**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 43, DATË 15.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
FUNKSIONIMIN E PROCESIT TË
SHKËMBIMIT TË DOKUMENTEVE
NDËRMJET INSTITUCIONEVE,
NËPËRMJET SISTEMIT TË
QARKULLIMIT TË DOKUMENTEVE
ME NËNSHKRIM ELEKTRONIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27, të ligjit nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 43, datë 15.1.2020, Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në fund të titullit të kreut shtohen fjalët “... MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT”;

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë si vijon:

“4. Nëpunësi publik është i detyruar që kërkesën për ndihmë administrative, për kryerjen e një ose disa veprimeve të nevojshme, veçanërisht për njohjen me dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër, sipas përcaktimit të nenit 71, të Kodit të Procedurës Administrative, ta dërgojë jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga paraqitja e kërkesës nga kërkuuesi. Në çdo rast, ndihma administrative, sipas kësaj pike, kërkohet nëpërmjet SQDNE-së.”.

c) Në pikën 11, fjalët “... pika 7...” zëvendësohen me “... pika 10...”.

ç) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Në mënyrë që të zbatohen afatet për shërbimin ndaj qytetarit, nëpunësit, eprori apo titullari do të kenë mundësinë e monitorimit nëpërmjet sistemit për të verifikuar statusin e kërkesës. Çdo nëpunës publik duhet të vetëdeklarojë, nëpërmjet sistemit, në ofrimin e shërbimit ose statusin e kërkesës, duke përfshirë



dhe datën në të cilën është ofruar ky shërbim te qytetari ose subjekti që ka bërë kërkesën.”.

d) Pas pikës 13 shtohen pikat 13/1, 13/2 dhe 13/3, me këtë përmbajtje:

“13/1. Lëvrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet shërbimofruese të kërkesave të bëra nga platforma *e-Albania* do të realizohet vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik.

13/2. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për monitorimin e raportimin e zbatimit të afateve dhe përdorimit të SQDNE-së, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve, deri në marrjen e shërbimit nga subjektet kërkuuese në portalin qeveritar *e-Albania*, sipas afateve ligjore.

13/3. Nëpunësit publikë përgjegjës raportojnë pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për vonesat, kërkesat e refuzuara apo gabimet gjatë procesit për kërkim dokumentacioni, ofrimin e shërbimit dhe masat e marra nga institucioni në rast vonese në ofrimin e shërbimit.”.

2. Pika 16, e kreut III, ndryshohet si më poshtë vijon:

“16. Për shkelje të rënda ose të përsëritura, të ndodhura brenda një institucioni ose kur konstatohet se shkeljet janë pasojë e mosorganizimit të brendshëm të punës në institucion, eprori direkt i nëpunësit publik:

a) trajtohet sipas përcaktimeve dhe procedurave të legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin kur ai është nëpunës civil;

b) merr masë administrative, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës, në rastin kur marrëdhënia e tij e punës rregullohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës apo me ligj të posaçëm.”.

II. Ngarkohen Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe institucionet e administratës publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 369, datë 22.6.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË
HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT PËR RIMËKËMBJEN E
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, RATIFIKUAR
ME LIGJIN NR. 170/2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, ratifikuar me ligjin nr. 170/2014, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



BANKA BOTËRORE
IBRD-IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Evropa dhe Rajoni i Azisë Qendrore

16 dhjetor 2020

Znj. Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

E nderuar znj. Ministre,

*Republika e Shqipërisë: Projekti i Rimëkëmbjes së Energjisë Elektrike (Huaja nr. 8429-AL)
Shtyrja e Datës së Mbylljes*

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja e Huas) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), të datës 3 nëntor 2014, për Projektin e Rimëkëmbjes së Energjisë Elektrike (Projekti) dhe Projekt Marrëveshjes ndërmjet Bankës Botërore dhe OST-së, KESH-it dhe OSHEE-së të së njëjtës datë si Projekti. Ne, gjithashtu, i referohemi letrës suaj, të datës 2 dhjetor 2020, me anë të së cilës i kërkon Bankës Botërore që të shtyjë datën e mbylljes të huas, me titullin e mësipërm, të parashikuar në Marrëveshjen e Huas.

Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 30 qershor 2021, si datë e mëvonshme, për qëllimet e seksionit V.B.2 të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas.

Me respekt,

Nënshkrimi
LINDA VAN GELDER

Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Evropa dhe Rajoni i Azisë Qendrore

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: + 43 (1) 2170 701

Znj. Anila Denaj

16 dhjetor 2020

Për dijeni: Znj. Belinda Balluku, ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
Znj. Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Z. Arian Hoxha, drejtor i Rimëkëmbjes së Energjisë Elektrike, PMU
Z. Benet Beci, drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, KESH
Z. Adrian Cela, drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, OSHEE
Z. Skerdi Drenova, drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, OST
Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretar i përgjithshëm dhe drejtor i përgjithshëm i Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, Këshilli i Ministrave
Z. Matteo Bugamelli, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

Për: Z./znj. Chavapricha, Daci, Fukui, Kramskaya, Khalili, Kim (IECEI); Malovic (CN2UP); Canale (IAFE1); Maho (GGO03); Myftiu (GGO21); Imeri (SCASO); Kastrati (SCAEN); Hafizi (ECCAL); Van Gelder, Widmann, Ljuca, Ellis, Kotere, Clower (ECCWB); Shqipëri DL; IECE1 Roser; WBDocs

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: + 43 (1) 2170 701



VENDIM
Nr. 370, datë 22.6.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I TREGUT TË
GJËSË SË GJALLË”, BASHKIA KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tregut të gjësë së gjallë”, Bashkia Korçë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh, të përballohet nga Bashkia Korçë.

5. Shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Bashkia Korçë.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të fillojë menjëherë pas

botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, pranë Bashkisë Korçë.

8. Bashkia Korçë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit, mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Korçë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“NDËRTIMI I TREGUT TË GJËSË SË GJALLË”

Nr.	PRONARI		TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)							VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Sip. që shpronësohet				
								Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	XHEVAIR	CAUSHLLARI	8564	132/17	arë	3,000	3,000	100	300,000	300,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	VASILIKA	KOSTA	8564	132/16	arë	6,000	6,000	100	600,000	600,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	AFROVITI	KOSTA	8564	132/15	arë	3,000	3,000	100	300,000	300,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	HENA	VASILI	8564	132/14	arë	9,000	9,000	100	900,000	900,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA										2,100,000	

**VENDIM****Nr. 371, datë 22.6.2021****PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË
SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA
E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR TEK
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, TË
PASURISË ME NR. 6/30, ZONA
KADASTRALE 8562, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor tek Autoriteti Rrugor Shqiptar, të pasurisë me nr. 6/30, zona kadastrale 8562, me sipërfaqe totale 560 m², Korçë, sipas planit të rëlvimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoret për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Autoritetit Rrugor Shqiptar sh.a., i ndalohet ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit bashkëlidhur vendimit nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës”, të ndryshuar, dhe i shtohet listës së inventarit bashkëlidhur vendimit nr. 3, datë 7.1.2005, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit”.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: D. P. SH. T. RR		DATE: 07/ 05/ 2021		QELLIMI: REGJISTRIM																																				
VENDNDODHJA BASHKIA KORÇË DVASHK/ZVASHK KORÇË ZONA KADASTRALE 8562 NUMRI PASURISE 6/30 INDEX HARTE KO - H - 11 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE TRUALL SIP.PASURISE= 560.00m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= 208.89m2 NUMRI KATEVE 3 ADRESA BLV"RILINDASIT"																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X 566945 Y 4500106 X 567042 Y 4500106 X 566945 Y 4500034 X 567042 Y 4500054																																								
SH 1:500 SHPIEGUES PER REGJISTRIM PASURIE: KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE ■ SIPERFAQE = 625.00m2 KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE ■ SIPERFAQE = 560.00m2																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>NR. PAS</td> <td>1/553, 6/570</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUGE</td> <td></td> <td>NR. PAS</td> <td>6/410, 6/408</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>NR. PAS</td> <td>6/408, 6/524</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>NR. PAS</td> <td>1/553</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		NR. PAS	1/553, 6/570			2	JUGE		NR. PAS	6/410, 6/408			3	LINDJE		NR. PAS	6/408, 6/524			4	PERENDIM		NR. PAS	1/553		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI		NR. PAS	1/553, 6/570																																				
2	JUGE		NR. PAS	6/410, 6/408																																				
3	LINDJE		NR. PAS	6/408, 6/524																																				
4	PERENDIM		NR. PAS	1/553																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: Ing. Esmerald Muçollari LICENCA: NR. T.1250 DATE: 24/ 07/ 2017 Digitally signed by Esmerald Muçollari Date: 2021.05.10 09:18:07 +02'00' TEKNOLOGJIA E MATJEVE: S, D Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: P Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA:																																								
NENSHKRIMI/VULA Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



URDHËR

Nr. 255, datë 17.6.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 216, DATË 29.5.2020, “PËR NJË PLAN
MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR
PESHKIMIN FUNDOR TË
QËNDRUESHËM NË DETIN ADRIATIK
(NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)
[REKOMANDIMI GFCM/43/2019/5]”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të “Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003, të neneve 13, 14 të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, të pikave 4 dhe 5, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”, të rregullores nr. 1, datë 7.3.2014, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 216, datë 29.5.2020, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 5, ndarja e kuotave të sforcos dhe ditëve të peshkimit, sipas porteve të peshkimit për vitin 2021, zëvendësohet me ndarjen e mëposhtme:

Porti i Peshkimit	Viti 2021
Durrës (56%)	12 700 ditë
Vlorë (14%)	3 200 ditë
Shëngjin (21%)	4 848 ditë
Sarandë (9%)	2 000 ditë

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 3, datë 8.2.2021, të Këshillit të Lartë të Arkivave, “Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve, për ruajtje të përhershme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 26 , datë 18.2.2021, bëhen korrigjimi i gabimit, si më poshtë:

- Shtojca nr. 1, e këtij vendimi, në kolonën: “përmasat e dosjeve për ruajtje të përhershme”, të korrigjohet, nga **37 x 26** në **36 x 24**, sipas materialit bashkëngjitur.

SHTOJCË 1

STANDARDET E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME PËR
ARKIVAT JO NË VEPRIM DHE PËR INSTITUCIONET QË RUAJNË DOKUMENTACION
GJITHNJË PRANË TYRE

Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40 x 28 x 18	Kutia: - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramaturë 620 gr/m² që të lejojë valzueshmërinë; - Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë; - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5; - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit; - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin; - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar); - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.



Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40 x 55 x 18	Dosja: - Kartoni të jetë 330 gr/m ² , me 2 krahë, krahët brenda të shkruara të palosur 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje; - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5; - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit; - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin; - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar); - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40 x 70 x 9	
Dosje për ruajtje të përhershme	36 x 24	

Bashkëngjitur dhe skicat e kutive dhe e dosjeve me ruajtje të përhershme.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë